




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Kujtesa Net” Sh.p.k.  
Numri i biznesit - 70585693  
Drejtor – Fiton PEJA  
K-Music  
Rr/Ukshin Hoti Nr.31,33,35  
Prishtinë

Ref:1808/949/LIC/ni

### **VENDIM**

për ndërprerjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) K- Music me transmetim përmes operatorëve të shpërndajës, me seli në Prishtinë

---

#### **Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. K-Music është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për ofrimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në pajtim me Rregullorën KPM-2016/01, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 6 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA K-Music.
3. Më datën 3 gusht 2018, OSHMA K-Music, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e KPM-së.

#### **Arsyetimi**

4. Duke marrë parasysh njoftimin e OSHMA K-Music, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së OSHMA K-Music.

#### **Vendim**

1/2

5. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 6 tetorë 2018, merr vendim për ndërprerjen e licencës së Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale K-Music, ndërsa, shlyerja e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.

6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.09.2018

datë